



Republika e Kosovës
Republika Kosovo -Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III
Sesioni pranveror

Kryesia e Kuvendit
P-92
Prishtinë, më 19 shkurt 2010, në orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, TË MBAJTUR MË 19 JANAR 2010

Në mbledhje morën pjesë: Jakup Krasniqi, Kryetar i Kuvendit, Xhavit Haliti, Sabri Hamiti, Eqrem Kryeziu, Ibrahim Gashi, Nexhat Daci Naim Maloku, Hetem Arifi dhe Slobodan Petroviq, anëtarë të Kryesisë.

Nga grupet parlamentare: Ramë Buja, Ardian Gjini, Ibrahim Makolli, Lulzim Zeneli, Xhezair Murati, Petar Miletqi dhe Numan Baliq.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Kabineti i Kryetarit të Kuvendit: Eshref Vishi, Ismet Hajrullahu dhe Skënder Reçica;

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Daut Beqiri, Sali Rexhepi, Selam Ymeri dhe Sherif Konjufca.

Nga Presidenca: Lumnije Rama,
Nga ICO: Blerta Bejtullahu,
Nga OSBE: Floriana Shala,
Nga NDI: Shefki Kastrati.

Mbledhjen e kryesoi **Jakup KRASNIQI**, Kryetar i Kuvendit.

Kryetari konstatoi se në mbledhjen marrin pjesë nëntë anëtarë të Kryesisë dhe shtatë kryetar të grupeve parlamentare dhe hapi punimet e mbledhjes së sotme.

Në fillim të mbledhjes, Kryetari u dëshiroi mirëseardhje dy kryetarëve të rinj të grupeve parlamentare: Petar Minitiq - GP të SLS dhe Numan Baliq – GP për Integritet.

Kryetari i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit të ditës, si dhe me materialet e shpërndara për këtë mbledhje.

Ai propozoi edhe një pikë shtesë, të cilën e miratoi Kryesia.

Në vazhdim, Kryesia i zhvilloi punimet me këtë:

R e n d i t e

1. Miratimi i Procesverbaleve të mbledhjeve të Kryesisë, të mbajtura më 08 dhe 16 shkurt 2010,
2. Propozimi i rendit të ditës për seancën e ardhshme plenare,
3. Shqyrtimi i mocioneve, i rekomandimeve dhe i kërkesave,
4. Të ndryshme.

1. Miratimi i Procesverbaleve të mbledhjeve të Kryesisë, të mbajtura më 08 dhe 16 shkurt 2010

Procesverbalet e mbledhjeve të Kryesisë, të mbajtura më 08 dhe 16 shkurt 2010, u miratua pa vërejtje.

2. Propozimi i rendit të ditës për seancën e ardhshme plenare

Kryesia, pasi shqyrtoi përgatitjet e nevojshme për secilën pikë, veç e veç, me pëlqimin e kryetarëve të grupeve parlamentare, **vendosi** që seanca plenare e Kuvendit të mbahet **më 25 shkurt 2010**, me këtë

R e n d i t e:

1. Miratimi i Procesverbalit të seancës plenare, të mbajtur më 11 shkurt 2010,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Shqyrtimi i parë i Projekt-kodit të drejtësisë për të mitur,
4. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për organizmat e modifikuar gjenetikisht,
5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për pyjet e Kosovës,
6. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për mbrojtjen e ajrit nga ndotja,

7. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për financimin e programeve të veçanta të banimit,
8. Propozim-Programi i punës së Kuvendit për vitin 2010,
9. Propozim-Plani i veprimit i Kuvendit për integrimet evropiane për vitin 2010,
10. Shqyrtimi i Propozim-vendimit të Qeverisë së Kosovës për lejimin e pagesës për furnizim me vaksina.

Propozim-Strategjia e energjisë për periudhën 2009-2018, me kërkesë të propozuesit, u shty për një seancë tjetër të radhës.

Debati, sipas kërkesës së Grupit Parlamentar të LDD-së, për zbatimin e Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe për praninë e strukturave të pushtetit të Serbisë në territorin e Republikës së Kosovës, në mungesë të Informatës së Qeverisë, u shty me arsyetimin se Kryesia e Kuvendit në mbledhjen e radhës, më 23 shkurt, do të konsultohet për procedimin e këtij debati në seancë të veçantë, më 26 shkurt 2010.

3. Shqyrtimi i mocioneve, i rekomandimeve dhe i kërkesave

3.1 Mocioni i deputetit Riza Smaka për amendamentimin e Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme

Kryesia, pasi shqyrtoi mocionin e cekur më lart, nxori këtë

P Ë R F U N D I M

Të konsultohet Presidenti i Republikës së Kosovës dhe partitë politike për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për zgjedhjet e përgjithshme.

3.2 Mocioni i deputetit Riza Smaka për amendamentimin e Ligjit për prokurimin publik

Kryesia, pasi shqyrtoi mocionin e cekur më lart, nxori këtë

P Ë R F U N D I M

Kërkohej nga Qeveria e Republikës së Kosovës që të japë mendimin lidhur me Mocionin e deputetit Riza Smaka për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L-99 për prokurimin publik.

3.3 Rekomandimi i Komisionit për Administratë Publike, Pushtet Lokal dhe Media për formimin e Komisionit Ad-Hoc, për emërimin e dy anëtarëve të Këshillit të Komisionit të Pavarur për Media

Kryesia, pasi shqyrtoi rekomandimin e cekur më lart, nxori këtë

P Ë R F U N D I M

Autorizohet Komisioni ad-hoc i mëparshëm, i formuar me vendim të Kuvendit nr. 03-V-113, datë 27 maj 2009, që të vazhdojë punën për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtarë në Këshillin e Komisionit të Pavarur për Media dhe Kuvendit t'ia paraqesë Raportin me rekomandime.

3.4 Kërkesa e Komisionit të Pavarur për Media për emërimin e një anëtari në Këshillin e Komisionit të Pavarur për Media

Kërkesa e cekur më lart u shty për mbledhjen e ardhshme të Kryesisë, me arsyetimin se duhet konsultuar bazën legale për procedimin e kësaj kërkesë.

3.5 Propozimi i Qeverisë për emërimin e anëtarëve të Bordit të Pavarur për Rishqyrtimin e Ankesave

Kryesia, pasi shqyrtoi propozimin e Qeverisë, nxori këtë

P Ë R F U N D I M

Ngarkohet Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion që ta shqyrtojë Propozim-vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e anëtarëve të Bordit të Autoritetit Rregullator të Hekurudhave të Kosovës dhe Kuvendit t'ia paraqesë Raportin me rekomandime.

Të ndryshme:

Nexhat Daci ngriti çështjen e zbatimit të vendimeve të Kuvendit dhe të Kryesisë. Ai kërkoi që vendimet e Kuvendit për shqyrtimin e Projektligjeve në afatin brenda dy muajve, pas miratimit në parim, duhen të respektohen nga komisionet parlamentare.

Numan Baliq ngriri çështjen e përfaqësimit të Grupit Parlamentar për Integrim në Kryesinë e Kuvendit.

Xhavit Haliti kërkoi që Kryesia e Kuvendit të njoftohet me agjendën e mbledhjeve të komisioneve parlamentare.

Kryetari e deklaroi të mbyllur mbledhjen e Kryesisë në orën 12:10 minuta.

Kryetari i Kuvendit,
Jakup KRASNIQI
